



FLETOJA ZYRTARE

E KRAHINËS AUTONOME TË KOSOVË — METOHIS

Dispozitat e këshillave popullore — (shtesë)

№ 14

Prishtine me 31 Korrik 1956

Vjet IV

Në bazë të nenit 57 te Ligjit mbi këshillat popullore të rretheve dhe nenit 25 te Statutit të Keshillit populluer të rrethit Pejë, — Keshilli populluer i rrethit Pejë në mbledhjet e veçanta të Dhomës së rrethit dhe Dhomës së prodhuesave mbajten muer këte

VENDIM

MBI TARIFAT PER SHERBIMIN QË I KRYEJ NE STASJONET E VETERINARIS DHE STASJONET BLEGTORALE-VETERINARE NË TERITORIN E RRETHIT PEJË

Neni 1

Në teritorin e rrethit Pejë paguhet për sherbimet që i bënë Stasjonet veterinarë dhe blegtoarlor veterinarë simbas tarifës që posht vijon:

A. PASQYRA E PERGJITHSHME KLINIKE

1. Kontrollimi i baktive të trasha pa aplikimin e barnave 100 din.
2. Kontrollimi i perseritun 80 din.
3. Kontrollimi i baktive t'imta (dhenëve, dhive dhe derrave) 80 din.
4. Kontrollimi i perseritun i baktive t'imta 60 din.
5. Kontrollimi i qejeve të barive dhe të gjahut dhe qeje roje 150 din.
6. Kontrollimi i perseritun 130 din.
7. Kontrollimi i qejeve luksuz, macave dhe baktive ekzotike kur nuk egziston dyshimi në terhim 300 din.
8. Kontrollimi i qejeve dhe macave me rastin e dyshimit në terhim (për çdo kontrollim) 200 din.
9. Kontrollimi i shpezeve 20 din.
10. Kontrollimi masovik i baktive të trasha ma tepër se 5 copë (pa kontrollim të posaçem klinik dhe humbje kohe) 500 din.
11. Për kontrollimin masovik të baktive t'imta mbi 5 copë (pa kontrollim të posaçem klinnik dhe humbje kohe) 300 din.

B. KONTROLLIMI SPECIJAL

1. Gjurmimi mikroskopik me ngjyrosjen e preparatit deri 5 preparata për një copë 100 din.
2. Gjurmimi mikroskopik me ngjyrosjen e preparateve mbi 5 preparata për një copë 60 din.
3. Gjurmimi mikroskopik t'eksperimenteve dhe preparateve pa ngjyrosje deri 5 cope për 1 cope 60 din.
4. Mbi 5 cope për 1 cope 20 din.
5. Aglutacioni i shpejt deri në 5 copë për 1 copë 20 din.
6. Për çdo gjurmim tjetër 10 din.

7. Të gjurmimit masovik tarifa paksohet për 50%
8. Analiza e vogel e urinit (ngjyrja, reaktioni, albumini, sheqeri e tjera kesodore (pa kataterizimin 80 din.
9. Sedimentacioni i gjakut 100 din.
10. Hemogrami 300 din.
11. Kontrollimi mikroskopik i qyrave te mitres për pjekuni 60 din.
12. Kubonat 120 din.
13. Aspoletë 100 din.

C. INTERVENIMI DHE KERKESAT

1. Lymja me medikamente të ndryshme sipërfaqen e lëkurës 50 din.
2. Ferkitimi me medikamente të ndryshme sipërfaqen e lëkurës 100 din.
3. Lamja dhe pastrimi i plagëve simbas madhësis së plagës 100-200 din.
4. Mjekimi i mitres 200 din.
5. Qepja e plages simbas madhësis dhe vendit 150-200 din.
6. Hapja e abcesit, hematoneve e tjera me aplikimin e barnave 200 din.
7. Klizma e baktive te trasha 100 din.
8. Klizma e baktive t'imta 100 din.
9. Shperlamja e stomakut të qenit 100 din.
10. Vumja e gipsit 200 din.
11. Rrxumja e kalit 300 din.
12. Rrxumja e gjedhit 150 din.
13. Narkoza e pergjithëshme 100 din.
14. Futja e zores në hunde dhe në stomak 209 din.

C. INTERVENIMET HIRURGJIKE

1. Lëshumja e gjakut me qellim mjekimi (Flpotomija) te kuajt dhe gjedhet 150 din.
- Te baktit e imta 100 din.
2. Marrja e gjakut për kontrollimin laboratik te kuajt dhe gjedhet 50 din.
- Te baktit e imta 30 din.
- Te shpezet 10 din.
3. Kauterizimi 500 din.
4. Operacione te lehta në sipërfaqen e lëkurës tue shkaktue plage 300 din.
5. Ekstipacioni i tumorit e tjerë të thatë simbas madhësis dhe vazhdimit të punës 200-500 din.
6. Operacioni në krye:
 - a) amputacioni i brinave, operacioni i ateronit, duktuesit, paradeusit, parotisit, entomiumit dhe tjera 400 din.
 - b) Trepauacioni 350 din.
 - c) Lemimi i dhambëve 150 din.
 - d) Ekstracioni dhe premja e dhambeve simbas madhësis te baktit e trasha 150 din.

7. Operacioni në qafë:

Hapja e sakusit, aerofolusit dhe sekcionit, ligemntumnubit, lidhja e arterjes haotis ose venes lugalalis, operacioni i fistules venoze, hapja e ezofagusit, traheotominacini, operacioni i thundrave 600 din.

8. Operacioni i krahnorit:

a) Fistulat dorezi 400 din.
b) Resekcioni i brinave 800 din.
c) Punkcioni i krahnorit 250 din.

9. Operacioni në bark

a) Punkcioni i veshkave dhe zorrve 200din.
b) Rumngo-gastro-enterotomioni i baktive të trasha 1000 din.
Baktive t'imta 100 din.
c) Hermitomioni simbas lokalizimit dhe peshës 1000 din.
ç) Laparatomioni te baktit e trasha 1.000 din.
te baktit e vogla 500 din.
d) Resekcioni i zorrëve 300 din.

10-Operacioni i organeve seksuale te mashkujve

a) kastracioni (tredhja) e hamshurve me rxumjen e racave të mbedha dhe të vogla 1.000 din.
b) kastracioni i demave 500 "
c) kastracioni i demave pa gjak me burdic. 150 "
ç) i deshve pa gjak 150 "
d) kastracioni i taroshve të derrave deri 5 copë 200 "
mbi 5 copë 100 "
dh) kastracioni i derkucave deri 5 copë 100 "
mbi 5 copë 20 "
e) kastracioni i kudrës 500 "
f) kastracioni i qejve dhe macave 400 "
g) kastracioni i priptorhidave të hamshurve dhe demave 2.000 "
h) kastracioni i kriptohidave të taroçve të derrave 20 "
i) kopunizacioni i gjelave 20 "
j) amputacioni i penisave 1.000 "
11. Operacioni dhe kërkesat në organet seksuale të femnave:
a) vertetimi i barsimit të pelës 400 "
b) vertetimi i barsimit të lopës 200 "
për çdo kontrollim mbi 10 copë paguhet kah 100 "
c) ovarijozomioni i lopve, pelave dhe bullicave 1.000 "
ç) ovarijezomioni i pertypsave të vogjel me shpenzimin e materjalit 200 "
d) nxjerrja e anit te baktit e trasha 1.000 din.
te baktit e vogla 500 "
dh) Pjellja e veshtire te baktit e trasha poembiotomion 1.000 din.
me embiotomion 2.000 "
e) Pjellja e veshtirë të baktit e imta 300 "
f) Prolapsuesi i vagines (repozicioni) 300 "
g) Prolapsuesi i utelit (repozicioni) 600 "

12. Ovarijatomioni i dosave deri në 5 copë 300 "
mbi 5 copë 150 "

13. Shtrydhja e pjeses së trupit dhe largimi i cistes 450 "

14. Operacioni i organeve të shurres:

a) uretrotomioni 400 "
b) vezikotomioni 500 "
c) kateterizirimi i kuajve dhe gomarve 200 "
" i baktive t'imta 50 "
" qejve 400 "

15. Operacioni i gjive:

a) amputacioni i cices 200 "
b) amputacioni i gjive 500 "
c) kateterizimi i kanalitë të cicës 200 "
ç) infuzioni intremamaran 100 "

16. Operacioni në ekstremitete:

a) tenotomioni, operacioni i polidaktilonit dhe neurotomioni 500 "

17. Operacioni i thundrave:

a) operacioni i thundrës së naltë, të poshtme dhe shtylles së thundrës, shkambit te zgavruem, mbrendësis celunionit e tjera 500 "
b) Ekstirpercioni i materjes së thunres 1.000 "
ç) Resekcioni i thundres së pritret 1.000 "

18. Amputacioni i bishtit të kalit 500 din.

10. Amputacioni i bishtit dhe premja e veshve të qejte për qellime kosmetike 400 "

D. INJEKSIONET

1. Sulkutane, intermuskulare, interadermale dhe interaperitoneale 60 "
2. Intratenoze dhe intratiaile 70 "
3. Extradepi dhe sudurali 80 "
4. Intratraheale injeksione kundra qimeve ne mushkni deri në 5 copë 300 "
mbi 5 copë të akcionet masovike poksohet tarifa si vijon: te baktit e trasha për 50%, të baktit e ima 75%, e të shpezet 90%.

DH. VAKCINIMI

1. Vakcinimi i organizuem i baktive të trasha në një vend 30 din.
2. Vakcinimi i paorganizuem i baktive trasha nëpër obore për copë 100 "
3. Vakcinimet t'organizueme të dhenve për 1 copë në një vend 50 "
4. Vakcinimi i paorganizuem i dhenve nëpër obore për një cop 30 "
5. Vakcinimi i organizuem i shpezve në një vend për një copë 50 "
6. Vakcinimi i pa organizuem i shpezve nëpër obore 10 "
7. Vakcinimi i organizuem i derrave në një vend 50 "
8. Vakcinimi i pa organizuem nëpër obore 100 "
9. Vakcinimi i organizuem i qejve në një vend për copë 80 "
10. Vakcinimi i qejve nëpër obore 200 "

Te gjitha vakcinimet në sektorin socialist konsiderohen t'organizueme.

E. VAKCINIMET DIJAGNOSTIKE

1. Tuberkulinizacjoni dhe trakutana, dhe kutana për copë 80 dinarë në bazë të ftesës në shtepi 300 din.
2. Malinizacjoni veç e veç në lidhje me shitblemjën e baktive dhe therjeve tyne për copë 50 din.

F. KONTROLLIMI I BAKTIVE PËR THERRJE

1. Kontrollimi i gjedhëve 100 dinarë
2. Kontrollimi i viçave 100 dinarë
3. kontrollimi i dhenv, dhive, deshve dhe capave 30 dinarë
4. kontrollimi i qingjave dhe i edhave 20 dinarë
5. kontrollimi i derrave 100 dinarë
6. kontrollimi i derkucave 40 dinarë
7. me rastin e therrjes për shkak të detyrimit tarif e caktueme shtohen për 50%.

I. SEKCIONI I BAKTIVE TË TRASHA

1. Sekcioni i baktive të trasha 500 dinarë
2. sekcioni i baktive t'imta 200 dinarë
3. sekcioni i qejve dhe i macave 300 dinarë
4. sekcioni i shpezve dhe leprave të buta 50 dinarë
Me rastin e sekcionit të breziq të ri tarifa e sipërme paksohet për 50%.

J. VERTETIMET NE CERTIFIKATAT E VETERINARIS

1. Lëshumja e vertetimit nga ana e veterinarit me përshkrimin e shtazes dhe gjendjen e saje 300 din.

2. lëshumja e certifikatës nga ana e veterinarit me shkoqitje dhe mendimi me rastin e shitblemjes, të konflikteve në gjyq e tjera tue i mos llogarit pullën taksa për baktit e trasha 500 dinarë, për t'imta 200 dinarë

Neni 2

- a) Për sherbimet që bahen mbrenda orarit të punës vlejné tarifit e naltë përmenduna të cilat jashtë orarit të punës shtohen 50% e për punën natën 100%.
- b) si punë e natës konsiderohet kontrollimi që bahet në mes t'orës 20 dhe 6 në periudhen prej 1 korrikut e deri me 30 shtatuer gjegjësisht prej ores 17 e deri në 7 në periudhen prej 1 tetorit deri me 30 qershuer.
- c) të hollat për barna, vakcionim dhe materjalin tjetër paguhen veç e veç shpenzimeve të bame e të lëshueme për 10% si shpërblim për shpenzimet transportuese — manipulative e tjera.
- c) Pë rsherbimet në teren, që kryen të shum persona gjegjësisht pronarë paguejnë shpërblimin simbas numrit të baktive të kontrollueme ose të sherrume në kohen e mjekimit të gjithë pronaret.
- d) Për kontrollimin e baktive në vendet që janë large prej ambulancës dhe vend banimit të veterinaris 4 ose ma tepër kilometra, pronaret paguejnë shpenzimet e transportit simbas dispozitave të Dekretligjit mbi shpenzimet e udhtimit dhe shpernguljes.
- dh) Për kohën e humbun prej momentit të ardhjes në vend për kontrollim e deri të momentit i kryemjes së punës paguhen 100 dinarë për orë.
- e) në rast dyshimi ose konstatimi t'infektimit të baktive nuk mund të paguhet kurfarë shpërblimi për sherbime. Ky shpërblim paguhet vetëm për kontrollimin e qejeve në të cilët dyshohet se janë të tërbuem e që kanë kafshue ndoi person ose bakti.
- f) Për sherbimet që nuk janë përfshi me këte tarife paguhen simbas tarifës se parapame t'Inspektimit veterinar në bazë të Fletores Zyrtare RFPJ Nr. 54/55.

Neni 3

Ky vendim (me tarifë) hyn në fuqi me ditën e botimit në Fletoren Zyrtare të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohis.

Nr. 8229

Në Pejë me 29-VI-1956

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT PEJË

KRYETARI
Bozho Radunović d.v.

Në bazë të nenit 14 dhe 57 pika 11 e Ligjit mbi këshillat popullore të rretheve, nenit 26 të Statutit të Këshillit populluer të rrethit Pejë dhe nenit 31 të Ligjit mbi peshkatarin (Fletorja Zyrtare e RPS Nr. 13/56), — Këshilli populluer i rrethit Pejë në mbledhjet e veçanta të Dhomës së rrethit dhe Dhomës së prodhuesave mbajtë me 29-VI-1956 muer këte

V E N D I M

MBI FORMIMIN E FONDIT TË PESHKATARIS

Neni 1

Për finansimin e masave me qellim përparimi të peshkataris në teritorin e rrethit Pejë formohet Fondi për përparimin e peshkataris të Këshillit populluer të rrethit Pejë (në tekstin e matejshëm Fondi).

Neni 2

Fondi ka cilsin e personit juridik dhe për detyrimet e tije përgjigjet me mjete të veta.

Neni 3

Fondi do të shfrytzohe vetëm për qëllimet për të cilat asht formue.

Neni 4

Mjetet e fondit formohen:

1. Prej pjeses të hollave të realizueme prej lejeve të lëshueme për peshkimin ekonomik si edhe prej pjeses së të hollave të realizueme prej lejeve vjetore që lëshohen për peshkimin sportiv e që vlejné për mbarë teritorin e Republikës popullore të Serbis e në shumën që cakton përqindja për çdo vjet Këshilli egzekutiv i Republikës popullore të Serbis.
2. Prej dotacioneve dhe dhuratave.
3. Prej të hollave të realizueme prej lejeve vjetore ose të nji ditë për pshkimin sportiv e që vlejné për teritorin e rrethit.
4. Prej kamatave në mjetet e fondit që derdhen në Bankë,
5. Prej t'ardhunave të tjera të fondit të caktueme me dispozitat të veçinta.

Neni 5

Mjetet nga neni 4 të këtij vendimi do të shfrytzohe për përparimin e peshkataris e sidomos për shumzimin e peshqive nepër lumejt e peshkimit dhe degve të tyne tue prodhue faren nëpër vendet ku qelin peshqit, për finansimin e investimeve të ndërimit të vendeve ku qelin peshqit dhe për blemjen e pajimeve për to, për mprojtjen dhe masa tjera të cilat parashifen me programin e Drejtoris së fondit për perdorimin e mjeteve të parapame.

Neni 6

Fondin e drejton Këshilli drejtues i cili përbahe prej 5 antarëve.

Antarët e Këshillit dretues të Fondit i emnon Këshilli populluer i rrethit. Këshilli drejtues disponon dhe i drejton mjetet e fondit në bazë të Ligjit dhe dispozitave tjera të përgjithëshme si edhe dispozitave të këtij vendimi dhe Rregullores së fondit.

Neni 7

Paralogarija e t'ardhunave dhe të dalunave të fondit që përpillohet në bazë të programit të punimeve për përparimin e peshkataris për çdo vjet përpillohet nga ana e Këshillit drejtues dhe i paraqitet për aprovim Këshillit populluer të rrethit.

Në fund të çdo vjeti Këshilli drejtues paraqet llogarin përfundimtare të fondit.

Neni 8

Mjetet e fondit derdhen dhe shendohen në llogair të veçant në Bankën popullore të RFPJ — Filijala në Pejë.

Mjetet e pashpenzue me Fondit të nji vjeti kalojnë në vjetin e ardhshëm.

Neni 9

Autorizohet Pleqsija për bujqsi dhe pylltari të Këshillit populluer të rrethit Pejë me dhanë udhëzime ma të hollsishme për mënyrën e shfrytzimit dhe për forma tjera të përdorimit të fondit.

Neni 10

Dispozitat ma të hollsishme mbi të drejtat dhe detyrat e Këshillit drejtues të fondit do të caktohen me Rregulloren e cila në bazë të propozimit të Këshillit drejtues e aprovon Këshilli populluer i rrethit.

Neni 11

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletorën Zyrtare të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohis.

Nr. 8222

Në Pejë me 29-VI-1956.

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT PEJË

KRYETARI

Bozho Rodunoviq d. v.

Në bazë të nenit 57 pika 11 e Ligjit mbi këshillat popullore të retheve, nenit 26 Të Statutit të Këshillit populluer të rrethit të Pejë Shtojces II nënkaptinës B/ Financat alineja XVII pika XV e Ligjit mbi kompetencën e këshillave popullore të komuneve dhe rretheve, në punët e rregullueme me dispozita federale, nenit 26 alineja 2 në lidhje me nenin 25 të Dekretligjit mbi katastrin e tokve (Fletorja zyrtare e RFPJ Nr. 43/53), e në bazë të pëlqimit të drejtoris geodete të KAKM-it Nr. 421 datë 22-V-1956, Këshilli populluer i rrethit Pejë në mbledhjet e Dhomës së rrethit dhe Dhomës së prodhuesave mbajtë me 29-VI-1956 muer këtë

VENDIM

MBI REVIDIMIN E KATASTRIT NË KUFIJT E KOMUNËS SË KATASTRIT NË VITOMIC

Neni 1

Lejohet revidimi i katastrit tue caktue klasat e tokës dhe tue konstatue gjendjen e re të veçant dhe të kulturave mbrenda kufijve të komunës së katas-trit në Vitomiric në teritorin e Këshillit populluer të komunës Pejë.

Neni 2

Revidimin e katastrit nga neni 1 i këtij vendimi do t'a bajnë komisioni i cili do të formohet në vesh-trim të nenit 17 alineja 2 të Dekretligjit mbi katas-trin e tokve.

Neni 3

Shpenzimet e revidimit për antarët e komisionit që cakton Këshilli populluer kompetent i komunës nga teritori i komunës së katastrit në Vitomiric i paguejnë detyruesat e tatimit të komunës katastrit në Vitomiric të cilët kanë kërkuue marrjen e këtij vendimi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi menjëher e do të botohet në Fletoren Zyrtare të KAKM-it.

Nr. 2075

Në Pejë me 29-VI-1956

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT PEJË

KRYETARI

Bozho Rodunoviq d. v.

Në bazë të nenit 57 pika 3 dhe 11 të Ligjit mbi këshillat popullore të retheve, nenit 26 pika 12 e Statutit të Këshillit populluer të rrethit Pejë, shtojca II, nënkaptulli B/ Financat, alineja XIX pika 3 Li-gjit mbi kompetencën e këshillave popullore të komuneve dhe rretheve në punët e rregullueme me dispozita federale, nenit 15, 17 dhe 27 të Dekretligjit mbi huanat për investime n'ekonomi (Fletorja Zyrtare RFPJ Nr.4/54) dhe nenit 1 dhe 12 të Dekretligjit mbi investimet shoqnore të fondeve (Fletorja Zyrtare RFPJ Nr. 22/56), kaptina XVI të Planit shoqner të rrethit Pejë për vjenit 1956, — Këshilli populluer i rrethit Pejë në mbledhjet e veçanta të Dhomës së rrethit dhe Dhomës së prodhuesave datë 29-VI-56 muer këtë

VENDIM

MBI FONDIN SHOQNER INVESTICJONAL TE RRETHIT PEJË

Neni 1

Formohet fondi shoqner investicjonal i rrethit Pejë për dhanjen kredi për investimet n'ekonomi.

Jashtëzakonisht, mjetet e Fondit shoqner inves-ticjonal munden me u përdore edhe për investimet jo ekonomike nëqoftëse këjo asht caktue me planin shoqner të rrethit.

Neni 2

Nga Fondi shoqner investicjonal mund të jepen vetem huana për investimet ekonomike dhe joekonomike.

Në rastet e jashtëzakonshme, mjetet nga Fondi shoqner investicjonal mund të jepen edhe për investime n'ekonomi pa detyrim që të këthohen këto nëqoftëse kështu asht caktue me dispozitat federale.

Neni 3

Autorizohet Pleqsija për planin shoqner dhe financa të Këshillit populluer të rrethit që mrenda kufive të dispozitave federale të caktojë kushte ma të hollsishme dhe mënyren për dhanjen e huanave nga fondi shoqner investicjonal i rrethit.

Neni 4

Mjetet e fondit shoqner investicjonal të rrethit formohen si vijon:

1. Prej pjesës të tijë t'organizatave ekonomike që asht caktue me dispozitat federale mbi ndamjen e t'ardhunave të përgjithëshme t'organizatave ekonomike në planin shoqner federal.

2. Prej t'ardhunave prej kamatave simbas huanave dhanë nga mjetet e ketij fondi.

3. Prej t'ardhunave të tjera të caktueme me dispozitat federale.

4. Prej dotacioneve nga buxheti i Këshillit populluer të rrethit.

Neni 5

Nga mjetet e Fondit shoqner investicjonal të rrethit mund të jepen huana investitorëve:

1. Për investime n'ekonomi,

2. Për shumat e garantueme dhe të gjitha obligime të tjera në huana, për investime n'ekonomi që i marrin organizatat ekonomike prej fondeve të tjera.

3. Për pjesmarrjen në shpenzimet e investimeve t'organizatave ekonomike të cilat marrin kredi ose finansohen prej fondeve të tjera.

4. Prej investimeve jo ekonomike.

Neni 6

Mjetet e fondit shoqner investicjonal të rrethit derdhen në llogari të veçant pranë Bankës popullore të RFPJ — Filijala Pejë.

Neni 7

Huanat nga fondi shoqner investicjonal të rrethit jepen me anë të konkurseve.

Këshilli drejtues i Bankës popullore të RFPJ — Filijala në Pejë shpall konkursin për dhanjen e huanave nga ky fond tue marrë ma parë pleqimin e Pleqsis për Planin shoqruer dhe financa të Këshillit populluer të rrethit.

Huanat nga Fondi shoqruer investicional të rrethit për investimet jo ekonomike jepen në bazë të kërkesave individuale.

Neni 8

Mjetet e këtij fondi të lejueme në bazë të nenit 2 alineja 2 e këtij vendimi për finansimin e investimeve n'ekonomi pa detyrim do të paguhen në mënyrë dhe nën kushtet që i cakton Pleqsisja për planin shoqruer dhe financa të Këshillit populluer të rrethit.

Neni 9

Banka Popullore e RFPJ — Filijala në Pejë asht mbartes i të drejtave dhe detyrimeve simbas kontratave të huanave dhanë nga mjetet e fondit. Në raste konflikti Banka asht palë e interesueme.

Neni 10

Banka popullore — Filijala në Pejë banë bilansin me 31 Dhjetur të çdo vjeti të t'ardhunave dhe të dalunave të hollave të fondit për vjetin përkatës dhe ka për detyrë të përpillojë deri kah fundi i muajt Prill të çdo vjeti llogarin përfundimtare për vjetin e kaluem.

Llogarin përfundimtare të Fondit shoqruer investicional Banka mbrenda afatit të caktuem n'alinen e sipërme i paraqet Sekretariatit për financa të Këshillit populluer të rrethit.

Këshilli populluer i rrethit aprovon llogarin përfundimtare të fondit.

Neni 11

Për shkeljen e dispozitave të këtij vendimi vlej në dispozitat mbi masat ndeshkuese nga Dekretligji mbi huanat për investimet n'ekonomi.

Neni 12

Me hymjen në fuqi të këtij vendimi abrogohet vendimi mbi formimin e Fondit për dhanjen kredi n'investimet për ekonomi të rrethit Pejë Nr. 5031/56 datë 12-III-1956, Kurse mjetet e përgjithëshme kalojnë në këte fond përfundimisht me gjendjen që konstatohet me ditën e 30-VI-1956.

Neni 13

Ky vendim hyn në fuqi në ditën kur asht marrë, e do të botohet në Fletoren Zyrtare të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohis.

Nr. 9199

Në Pejë me 29-VI-1956

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT PEJË

KRYETARI
Bozho Rodunoviqd.v.

Në bazë të nenit 57 të Ligjit mbi këshillat popullore të rretheve, nenit 26 pika 12 e Statutit të Rrethit Pejë, nenit 2 të Dekretligjit mbi fondet për udhë (Fletorja Zyrtare e RFPJ Nr. 19/56) dhe kaptinës 16 pika 2 e Planit shoqruer të Rrethit Pejë për vjetin 1956, — Këshilli populluer i rrethit Pejë në mbledhjet e veçanta të Dhomës së rrethit dhe Dhomës së prodhuesave mbajtë me 29-VI-1956 muer këte

VENDIM

MBI FORMIMIN E FONDIT PËR UDHET E RADHES III TË RRETHIT PEJË

Neni 1

Formohet fondi për udhë të rendit III të rrethit Pejë (në tekstin e matejshëm Fondi për udhë).

Neni 2

Fondi për udhë formohet për të sigurue mjetet financijare për mbajtjen, rekonstrukcionin, modernizimin dhe ndertimin e udhëve të rendit III në teritorinë e rrethit Pejë.

Neni 3

Fondi për udhë asht Fond buxhetuer.

T'ardhunat dhe të dalunat e Fondit për udhë parashifen dhe aprovoen me parallogarin e fondit në bazë të dispozitave mbi buxhetet.

Parallogarija e t'ardhunave dhe të dalunave të fondit për udhë asht pjesë përbasë e buxhetit dhe e aprovon Këshilli populluer i rrethit.

Jashtzakonisht për vjetin 1956 autorizohet Pleqsisja për planin shoqruer dhe financa që në bazë të propozimit të Këshillit për udhë t'a aprovojë parallogarin e t'ardhunave dhe të dalunave për udhë për këtë vjet.

Neni 4

Mjetet e fondit për udhë formohen:

1. Prej taksave (shtetnore dhe komunale) që paguhen për regjistrimin e mjeteve transportuese dhe mjeteve me kafshë në bazë të dispozitave mbi taksat.

2. Prej t'ardhunave që merrën prej shitjes së barit, pemve dhe drujve që u takojnë udhëve të rradhës së III.

3. Prej gjobave që merren për shkak të shkeljes së dispozitave të komunikacionit e që i cakton organi i Këshillit populluer të rrethit.

4. Prej dotacionit nga buxheti i Këshillit populluer të rrethit.

5. Prej dhuratave, huanave dhe t'ardhunave të tjera kesodore.

Neni 5

Mjetet e fondit për udhë nuk mund të përdorën për qillime të tjera përpos t'atyne që janë caktue në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 6

Mjetet e fondit për udhë derdhen në llogari të veçantë në Bankën popullore të RFPJ — Filijala në Pejë.

Neni 7

Fondin e drejton Drejtorati për udhë i Këshillit populluer të rrethit Pejë.

Neni 8

Organi që drejton Fondin për udhë ka për detyrë që para fillimit të vjetit të përpillojë parallogarin e t'ardhunave dhe të dalunave të fondit për vjetin e ardhëshëm.

Mbas kalimit të vjetit organi i drejtimit të fondit për udhë ka për detyrë me përpillue llogarin përfundimtare së bashku me raportin mbi punën e fondit për udhë.

Parallogarija e t'ardhunave dhe të dalunave dhe llogarija përfundimtare e fondit për udhë përpillohet në bazë të dispozitave mbi përpilimin e parallogaris së t'ardhunave dhe të dalunave të fondit dhe buxhetit gjegjesisht simbas dispozitave mbi buxhetin.

Neni 9

Fondi për udhë rezervën e detyrueshme e cila sigurohet në parallogarin e t'ardhunave dhe të dalunave të fondit në shumën 10% të t'ardhunave të përgjithëshme të planifikueme nëqoftëse këjo shumë nuk caktohet ndryshme dispozita republikane.

Rezerva e detyrueshme e fondit për udhë shërbën për mbulimin e shpenzimeve të parapame në parallogarin e t'ardhunave dhe të dalunave në rast se t'ardhunat nuk derdhen simbas planit të parashikuem në Fond si edhe për mbulimin e të dalunave të pa parapame ose të parapame jotemjeftueshme të Fondit.

Neni 10

Parallogarija e t'ardhunave dhe të dalunave për udhë zbatohet nga ana e urdhëndhanësit. Urdhëndhanës për zbatimin e parallogaris t'ardhunave dhe të dalunave është Drejtori i drejtoratit për udhë i Këshillit populluer të rrethit.

Neni 11

Autorizohet urdhëndhanësi me ba ndryshimin e shumës të hollave mbas aprovimit të parallogaris t'ardhunave dhe të dalunave deri në 300.000 dinare.

Neni 12

Mjetet e fondit për udhë që nuk shpenzohen gjatë vjetit kalojnë në vjetin e ardhëshëm.

Neni 13

Organi i caktuem me Ligjin themeluer mbi buxhetet mbikqyrë përdorimin e mjeteve për udhë, kurse në pikpamje të realizimit të t'ardhunave të Fondit këte mbikqyrje e banë inspektimi financiar.

Neni 14

Ky vendim hyn në fuqi në ditën kur është marrë e do të botohet në Fletoren Zyrtare të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohis.

Nr. 9198

Në Pejë me 29-VI-1956.

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT PEJË

KRYETARI

Bozho Rodunoviq.d.v.

Në bazë të nenit 57 të Ligjit mbi këshillat popullore të rretheve dhe nenit 26 pika 2 e Statutit të Këshillit populluer të rrethit Pejë, — Këshillit populluer i rrethit Pejë në mbledhjet e veçanta të Dhomës së rrethit dhe Dhomës së prodhuesave datë 29-VI-1956 dha këte

U R D H E N E S E

MBI MINIMUMUN E MASAVE AGROTEHNIKE DHE ZOOTEHNIKE TE CILAT JANË TË DETYRUESHME ME I PERDORË EKONOMIT BUJQSORE SOCIAJLISTE NË TERITORIN E RRETHIT PEJË

Për me përparue prodhimin bujqësor në ekonomit bujqësorë socialiste — në pasunit bujqësore, Ekonomit e farëve, fidanishtat dhe në ekonomit kooperativave bujqësore në tekstin e matejshëm (Ekonomit), — Ekonomit kanë për detyrë me perdoe minimume masave agrotehnikë dhe zootehnikë.

Në kuptimin e perdores të minimumit të masave agrotehnikë dhe zootehnikë duhet nenkuptue dhe krye nga ana e ekonomive nga pika 1 e kesaj urdhenese këto masa.

1. Klacifikacioni me humifikacionin e tokës është 10% prej sipërfaqeve te tokave te punuame,

2. Me qerue dhe plehune farën e drihtnave të bardhë si edhe me kontrollue aftesin e mbimjes të të gjitha farëve 100%.

3. Me perdoe vetëm farën e kualitetit te mire simbas reonizimit 60% ,

4. Me mbjelle me kohë 100%,

5. me i vllaqit bimet e dimnit 100%,

6. Me perdoe plehnat artificjal ne te gjitha kul turat 60%,

7. Me i perdoe masat për zhdukjen e barit të keq tue hjerre ose tue çvarose me mjete kimike 100%

8. Me i lavrue sternishtaq me njiher mbas korries dhe me ba lavrimin e thellë 60%.

9. Mbjelljet e leguminoses njivçeqare në sipërfaqet prej 10% te sipërfaqeve t-arave.

10. Me i pastrue mekanikisht dhe me i sterpik pe met kundra damtusave dhe semundjeve 100%.

11. Me vaksinue baktit dhe shpezet kundra infektimit dhe semundjeve 100%.

III

Masat agrotehnikë dhe zootehnikë të parapame me këte urdhenesë duhet të zbatohen pa tjetër nga ana e të gjitha ekonomive socialiste si gjatë ketij vjeti ashtu dhe mandej ne vjetet e ardheshme.

Nëqoftese ekonomit masat e parapame në pikën II të kesaj urdhenesë nuk i zbatojnë ose nuk i zbatojnë me kohe per arsylene te pajustificueshem keshillat popullore të komuneve ose Keshilli populluer i rrethit mundet me urdhenue organizaten tjetër ekonomike per me i zbatue masat e parapame në ekonomit perkatsë e me shpenzimet e ekonomis qe buk i ka zbatue keto masa.

IV

Keshillat popullore te komuneve dhe organet e inspektimit bujqësor dhe veterinar të Keshillit populluer të rrethit do të kontrollojnë zbatimin e masave të parapame me këte vendim.

V

Për shkeljen e dispozitave të kesaj urdhenese Ekonomit pergjegjes gojbiten deri ne 30000 dinare.

Gjyqtari për kundravajtje i Keshillit populluer të komunes zhvillon proceduren administrativo ndeshkuese dhe cakton gjoben.

Per shkeljen e dispozitave te Ligjit themeluer mbi mprojtjen i bimeve prej semundjeve dhe damtusave, te Ligjit themeluer mbi mprojtjen e baktive prej semundjeve te baktive dhe Ligjit mbi qarkullimin e materjalit të fares te parapam me kete urdhenesë piken 2, denimet do te caktohen simbas dispozitave të ketyne ligjeve.

Gjyqtri për kundravajtje i Keshillit populluer te rrethit zhvillon proceduren administrativo ndeshkuese dhe cakton denimet per shkeljen e dispozitave nga alineja e sipërme.

VI

Kejo urdhenese hyn ne fuqi ne ditën kur është dhane e do te botohet ne Fletoren Zyrtare te Krahinës Autonome te Kosoves e Metohis.

Nr. 7188

Ne Pejë me 29-VI-1956

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT PEJË

KRYETARI

Bozho Radunoviq. dv.

BILANSIi Xehrores se magnezitit „Golesh” Lipjan
datë 31-XII-1955

AKTIVA

PASIVA

Nr. rend.	EMNI I POZICIONIT	Shuma	Nr. rend.	EMNI I POZICIONIT	Shuma
A. MJETET THEMELORE DHE TE NDDAME			A. BURIMET E MJETEVE THEMELORE DHE TE NDDAME		
1	Mjetet themelore	734.523	1	Fondi i mjeteve themelore	658.330
2	Investimet në rrjedhim e sipër	12.789	2	Kredija me afat të gjatë për krymjën e investimeve	66.405
3	Mjetet e ndame dhe mjetet tjera për investime	110.573	3	Fondet e ndryshme	126.433
B. MJETET QARKULLUESE			B. BURIMET E MJETEVE QARKULLUESE		
4	Mjetet e pergjithshëm qarkullese	143.200	4	Kredija me aft të gjatë për finansimin e investimeve	12.977
C. MJETET NE LLOGARI DHE AKTIVA TJETER			C. BURIMET E MJETEVE NE LLOGARI DHE PASIVA TJETER		
5	Blersat dhe kërkesat tjera	48.652	6	Banka — kredija per mjetet qarkulluese	105.401
6	Aktiva tjetër	8.378	7	Fondi i mjeteve qarkulluese	
C. REZULTATI FINANCIJAR			C. REZULTATI FINACIJAR		
8	Humbja		8	Kohnat e kufizuese pasive	
GJITHESEJT:			GJITHESEJT:		
		1.261.703			1.261.703

Udhëqsi i kontabilitetit
Miloje Panteliq. dv.KRUETARI
i Këshillit drejtueseDrejtori i sipermar
Zh. Bajram. dv.**BILANSI**i Sipermarjes tregtare „Likura — Lesh” — Pristine
datë 31.XII.1955

AKTIVA

PASIVA

Nr. rend.	EMNI I POZICIONIT	Shuma	Nr. rend.	EMNI I POZICIONIT	Shuma
A. MJETET THEMELORE DHE TE NDDAME			A. BURIMET E MJETEVE THEMELORE DHE TE NDDAME		
1	Mjetet themelore	50	1	Fondi i mjeteve themelore	50
2	Investimet në rrjedhim e sipër		2	Kredija me afat të gjatë për kryemjën e investimeve	
3	Mjetet e ndame dhe mjetet tjera për investime	495	3	Fondet e ndryshme	638
B. MJETET QARKULLUESE			B. BURIMET E MJETEVE QARKULLUESE		
4	Mjetet e pergjithshëm qarkulluese	16.319	4	Kredija me afat të gjatë për finansimin e investimeve	
C. MJETET NE LLOGARI DHE AKTIVA TJETER			C. BURIMET E MJETEVE NE LLOGARI DHE PASIVA TJETER		
5	Blersat dhe kërkesat tjera	1.547	5	Burimet tjera për finansimin e investimeve	
6	Aktiva tjetër		6	Banka — kredija per mjetet qarkulluese	284
C. REZULTATI FINANCIJAR			C. REZULTATI FINACIJAR		
7	Ndimja e fitimit		7	Kohnat e kufizuese pasive	
8	Humbja		8	Fondi i mjeteve qarkulluese	
GJITHESEJT			GJITHESEJT		
		18.411			18.411

Udhëqsi i kontabilitetit
Danica Djordjeviq. dv.KRUETARI i Këshillit drejtuese
Jovan Janiqijeviq. dv.Drejtori i sipermar
Borisha Mrdakoviq. dv.

BILANSI

i Sipermarjes per furnizimin e bujqsis „Kosmet” — Prishtina

AKTIVA			PASIVA		
datë 31-XII-1955					
Nr. rend.	EMNI I POZICIONIT	Shuma	Nr. rend.	EMNI I POZICIONIT	Shuma
A. MJETET THEMELORE DHE TE NDDAME			A. BURIMET E MJETEVE THEMELORE DHE TE NDAME		
1	Mjetet themelore	1.742	1	Fondi i mjeteve themelore	1.742
2	Investimet në rrjedhim e sipër		2	Kredija me afat të gjatë për krymjën e investimeve	
3	Mjetet e ndame dhe mjetet tjera Për investime	9.764	3	Fonde e ndrushme	9.519
B. MJETET QARKULLUESE			B. BURIMET E MJETEVE QARKULLUESE		
4	Mjetet e pergjithshme qarkulluese	43.492	4	Kredija me afat të gjatë për finansimin e investimeve	
C. MJETET NE LLOGARI DHE AKTIVA TJETER			C. BURIMET E MJETEVE NE LLOGARI DHE PASIVA TJETER		
5	Blersat dhe kërkesat tjera	48.706	5	Burimet tjera për finansimin	
6	Aktiva tjetër		6	Banka — kredija per mjetet qarkulluese	60.308
Ç. REZULTATI FINANCIJAR			Ç. REZULTATI FINACIJAR		
7	Ndamja e fitimit	1.096	7	Fondi i mjeteve qarkulluese	
8	Humbja		8	Kohnat e kufizueme pasive	
GJITHESEJT			GJITHESEJT		
		104.800			104.800

Udhëqsi i kontabilitetit
Shaban Lepaja. dv.KRUETARI i Këshillit drejtuese
Lubisha Mikiq. dv.Drejtori i sipermar
Bogoljub Stevanoviq. dv.

PËRMBAJTJA

- Vendimi mbi tarifatat per sherbimin qe i kryjne stasjonet e veterinaris dhe stasjonet blegtorale veterinare ne teritorin e rrethit Peje — 153
- Vendimi i KPRR Peje mbi formimin e Fondit te peshkataris — — — — — 155
- Vendimi mbi revidimin e katastrit ne kufijt e komunes se katastrit ne Vitimiric — — — 156
- Vendimi mbi fondin shoqruer investiconal te rrethit Peje — — — — — 156
- Vendimi mbi formimin e fondit per udhet e radhes se III te rrethit Peje — — — — 157
- Urdhënese mbi minimumin e masave agrotehni

ke dhe zootehniket te cilat jane te detyruesheme me i perdore ekonomit bujqesore socialiste ne teritorin e Rrethit Peje — — — — — 158

7 Bilanset:

- Xehrores se magnezitit „Golesh” Lipjan — 159
- I Sipermarjes tregtare „Likura-Lesh” Prishtine — — — — — 159
- I Sipermarjes per furnizimin e bujqsis „Kosmet Prishtine” — — — — — 160

■ boton Këshilli egzekutiv i KA të Kosovë-Metohis — Drejtorati për dispozitat krahinore dhe organizimin — Redaktori përgjegjës Sokol Dobrosi Prishtinë — telefoni Nr. 419. Dorëshkrimet dhe shpalljet dërgohen n'adresën: Administrata e „Fletores Zyrtare të KA të Kosovë-Metohis” në Prishtinë — Llogarja rrjedhese Nr. 21—KB—1—ZH—76. — Parapagimi për vjetin 1956 kushton 500 dinarë. E shtyp shtypshkronja „Milladin Popoviq” Prishtinë.